

Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Deçan
Rruga Jashar Salihu, p.n.
51000 Deçan

REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA KOSOVA	
			
GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN QSNËVNI SUD PEÇ OGRANAK DEÇANE			
Pranuar - Primiçeno: 01-06-2020			
Nj.Pun. Org.jeti	Nr.	Br.	Shtojcë Prilog
			Vlera Vrednost

Në mbështetje të Nenit 252 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, tash e tutje referuar si **Ligji për Procedurën Kontestimore**, në lidhshmëri me Nenin 4, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 02/L65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, tash e tutje referuar si **Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes**, Kelkos Energy Sh.P.K., me numër unik identifikues 810796005 dhe adresë në Rruga Demë Ali Pozhari Nr.4., Deçan, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, Arianit Koci dhe Granit Vokshi, avokatë, me adresë në Rrugën Robert Doll, Nr.34, 10000, Prishtinë, me respekt, parashtron këtë:

PADI PËR KOMPENSIM DËMI PËR SHKAK TË SHPIFJES

Paditës:

KELKOS ENERGY Sh.P.K., me numër unik identifikues 810796005 dhe adresë në Rruga Demë Ali Pozhari Nr.41, Deçan, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, Arianit Koci dhe Granit Vokshi, avokatë, tutje referuar si "**Paditësi**"

E Paditur:

Shpresa Loshaj, përfaqësuese e Organizatës Joqeveritare Pishtarët tash e tutje referuar si "**e Paditura**"

Vlera e Kontestit:

EUR 100.000,00 (me fjalë: njëqind mijë Euro)

27 maj 2020

1. Konstatimi i shpifjes

- 1.1. KelKos Energy Sh.p.k. është një kompani e licencuar sipas ligjeve në Kosovë për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtësishme të energjisë me katër hidrocentrale të ndryshme. E njëjta është në mesin e prodhuesve më të mëdhej të energjisë nga burimet e ripërtërishme në Kosovë. Në vitin 2009 KelKos Energy Sh.p.k. është themeluar si vartëse e KI-KELAG International GmbH, që është pjesë e grupit energjetik me bazë në Austri Kelag. Kelag, e cila filloi veprimtarinë në 1923, është aktive në prodhimin e energjisë, prokurimin, distribuim dhe shitjen e energjisë së lidhur me rrjetin dhe operon me më shumë se 70 hidrocentrale në Evropë. Kompania Kelkos Sh.p.k., është një nga investitorët privat më të mëdhenjë në Republikën e Kosovës me një volum të investimit në burimet e ripërtërishme të energjisë prej EUR 60.000.000 (me fjalë: **gjashtëdhjetë milion Euro**).
- 1.2. Me datë 8 maj 2020, Znj. Shpresa Loshaj si themeluese e Organizatës Joqeveritare Pishtarët, i është drejtuar anëtarëve të Bordit dhe zëdhënësit të Zyrës së Rregullatorit për Energji Elektrike (ZRRrE), me një letër e cila përmban shpifje në lidhje me pretendimet e saj për kinse kundërligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarrjes Kelkos Energy. Sipas kësaj letre, Padiësja pretendon se licenca e poseduar nga Kelkos Energy për prodhimin e energjisë është në kundërshtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energji Elektrike si dhe Rregulloren për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë.
- 1.3. E Padiësja, vazhdon të elaborojë disa dispozita të ligjeve dhe rregullores së lartcekur, kështu duke i interpretuar të njëjtat sipas vlerësimit të saj personal, dhe duke i quajtur licencat e lëshuara zyrtarisht për Padiësin 'licenca fiktive', rrjedhimisht duke dhënë deklarata të pavërteta në dëm të Padiësit. Deklarata të tilla të pavërteta të cilat çenojnë integritetin dhe reputacionin e individëve sanksionohen më anë të dispozitave ligjore.

Prova Nr. 1: Letra e datës 8 maj

- 1.4. Më 6 maj 2020 e Padiësja me të njëjtat shpifje i është drejtuar ministrit të mjedisit në detyrë Z. Lumir Abdixhiku dhe zëvendësministrit në detyrë Z. Avni Zogiani duke thënë se ndërmarrja Kelkos Energy operon në mënyrë të jashtëligjshme në territorin e Kosovës.

Prova Nr. 2: Letra e datës 6 maj

- 1.5. Për më tepër, me datë 13 maj 2020, në profilin e saj në Facebook, e Padiësja ka shpërndarë një video, duke kontestuar ligjshmërinë e hidrocentraleve të Padiësit, dhe duke deklaruar se Padiësi është duke kontribuar në shkatërrimin e mjedisit dhe natyrës, të gjitha këto në mungesë të Lejes Mjedisore.

Prova Nr. 3: Linku i videos

<https://www.youtube.com/watch?v=2hahTDZDdvA&feature=youtu.be>

- 1.6. Me datën 16 Maj 2020 e Paditura nëpërmjet një interviste të dhënë në televizionin nacional KTV, ka vazhduar me deklarime shpifëse ndaj Paditësit. Ndër të tjera ajo duke u deklaruar kinse në cilësinë e ekspertës e sulmon drejtëpërdrejtë Paditësin duke pretenduar se i njëjti nuk ka leje për prodhim të energjisë, ka shkatërruar mjedisin dhe se i njëjti nuk aplikon për Leje Mjedisore. Deklarimet e saja artikuloohen si në vijim:

“Sidomos Hidrocentralet e Deçanit këtu nuk kanë as leje dhe kanë prodhu rrymë me vite, e kanë shkatërru mjedisin komplet. Pastaj ajo vazhdon me pyetjen se ‘Pse këto nuk aplikojnë për leje mjedisore dhe ta marrin licencën në mënyrën ligjore’? Por aq shumë kanë shkakto dëmtin të mjedisit sa që nuk dojnë as me rehabilitu natyrën edhe me shku drejtë procesit ligjor. E kanë mashtrru popullin, Ligji nuk ju jap mandat me kry atë punë. Mashtrim i papranueshëm.”

- 1.7. Në bazë të deklaratave të të Paditurës, të cilat nuk mbështeten në asnjë provë të vetme, në letrat drejtuar Anëtarëve të Bordit dhe zëdhënësit të ZRrE, Ministrit dhe Zëvendës Ministrit në detyrë Lumir Abdixhiku dhe Avni Zogiani, ndërmarrja Kelkos Energy supozohet që operon në bazë të licencave fiktive për prodhim të energjisë elektrike. Mirëpo, këto deklarata siç u sqarua më lartë përmbajnë shumë elemente shpifëse.
- 1.8. E Para, Paditësi posedon licenca për prodhim të energjisë elektrike për të gjitha hidrocentralet e veta, që janë të publikuara në faqen zyrtare të ZRrE-së. Marrë parasysh transparencën e këtyre procedurave dhe licencave dhe publikimit në kohë të tyre, e Paditura është dashur të jetë e vetëdijshme se deklaratat e saj se i njëjti operon pa licencë dhe se qytetarët e Deçanit nuk ishin në dijeni për ndodhitë, janë të pavërteta.
- 1.9. Paditësi Kelkos Energy është i pajisur me Licencën Nr. ZRRE/Li_64/18 të datës 14 tetor 2019 për prodhimin e energjisë elektrike për HC Lumbardhi II. Paditësi është i pajisur me Licencën Nr. ZRRE/Li_50/16 të datës 14 tetor 2019 për HEC Belaje dhe Licencën Nr. ZRRE/Li_49/16 të datës 14 tetor 2019 për HEC Decani, të cilat janë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike, dhe Rregulloren për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Prova Nr. 4: Licenca Nr. ZRRE/Li_64/18

Prova Nr. 5: Licenca Nr. ZRRE/Li_50/16

Prova Nr. 6: Licenca Nr. ZRRE/Li_49/16

Prova Nr. 7: Vendimi V_1183_2019

Prova Nr. 8: Vendimi V_1184_2019

Prova Nr. 9: Vendimi V_1182_2019

- 1.10. Më tutje, e Paditura shpërndan deklarata shpifëse se kinse Paditësi nuk ka aplikuar për leje mjedisore ngase sipas së Paditurës, nuk është i interesuar që të revitalizoj natyrën e degraduar. Kjo deklaratë është e pavërtetë dhe shpifëse në disa nivele. Fillimisht, është e pavërtetë se Paditësi nuk ka aplikuar për Leje Mjedisore. Në fakt, Paditësi ka aplikuar për leje mjedisore qysh më datën 27.09.2019, ashtu siç vërtetohet edhe nga aplikacioni 5837/19.

Prova Nr. 10: Aplikacioni për leje mjedisore

- 1.11. E dyta, në kundërshtim me narracionin e paraqitur nga ana e të Paditurës, procesi i vlerësimit të aplikacionit për leje mjedisore është ndërprerë për shkak të reduktimit esencial të aktiviteteve të resorëve kompetent brenda organeve shtetërore për shkak të pandemisë Covid-19.
- 1.12. E treta, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në procesin e trajtimit të lejes mjedisore të Kelkos Sh.P.K., ka vlerësuar nëpërmjet inspektorëve progresin e rehabilitimit dhe rikultivimit, që Paditësi e ka filluar që nga kompletimi i punëve ndërtimore në vitin 2017. Është konfirmuar në procesverbale të shumta inspektuese që rehabilitimi natyral është kompletuar me sukses në nivelin e kënaqshëm për inspektorët. Kjo kundërshton deklaratën e së Paditurës që Paditësi nuk dëshiron të rehabilitoj natyrën.
- 1.13. Për më tepër, Paditësi me datën 20.09.2019 nëpërmjet vendimit Nr. ZSP-1220/2019 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka marrë Lejen e Përdorimit për Hydrocentralin HEC - Belaja dhe HEC - Deçan, Komuna e Deçanit, ndërsa që me datën 23.08.2019 nëpërmjet vendimit me Nr. ZSP- 1072/2019 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka marrë Lejen e Përdorimit për HEC "Lumbardhi II". Vetëm me këto Leje Përdorimi në dorë, Paditësi ka mundur të aplikoj për Leje Mjedisore, gjë që Paditësi e ka bërë pa vonesë.

Prova Nr.11: Vendimi Nr. ZSP-1220/2019

Prova Nr.12: Vendimi me Nr. ZSP-1072/2019

- 1.14. Paditësi, sikur shumica e projekteve tjera të gjenerimit të energjisë elektrike, gjindet në fazën e fundit të marrjes së lejes mjedisore. Ky segment i Ministrisë së Mjedisit përmban dhjetra aplikacione, mes tjerash edhe centralin elektrik nga thëngjilli Kosova A.
- 1.15. Është e dukshme që e Paditura ka pasur tendencë që të dëmtoj Paditësin duke pretenduar se ka "zbuluar" një informatë për një temë që në fakt është e pavërtetë, që tanimë ishte e njohur në publik. Një tentim shpifjeje i tillë shihet pas akuzimit falso pra se Paditësi ende nuk ka aplikuar për t'u pajisur me leje mjedisore. Për shkak të infrastrukturës ligjore të mangët të kapacitetit administrativ që ka shkaktuar vonesa në Ministrinë e Infrastrukturës (Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë), deri më tani asnjë hidrocentral brenda territorit të Kosovës nuk është pajisur me Leje Mjedisore. Prandaj, jo vetëm prodhuesit e energjisë elektrike me bazë hidrocentralet, por edhe disa prodhuesve me erë janë pajisur me Licencat e Përkohshme nga ana e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për të mundësuar gjenerimin e energjisë së gjelbër në mungesë të Lejeve Mjedisore.
- 1.16. Mjafton të përmendet Vendimi i ZRRE-së i lëshuar me datën 15 Nëntor 2018 me numër V-1070_2018 që i lëshon Licencë të Përkohshme për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Parku me Erë "Kitka" ndërmarrjes "Air-Energy" Sh.p.k apo

dhe Vendimit V_1140_2019 që lëshon Licencë të Përkohshme për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Hidrocentrali "Lepenci" 3, ndërmarrjes "Hydroenergj" Sh.p.k.

Prova Nr. 13: Vendimi Nr. V_1070_2018

Prova Nr. 14: Vendimi Nr. V_1140_2019

1.17. Megjithatë, ajo çfarë është edhe më indikative lidhur me vonesën e procesit të marrjes së lejes mjedisore, respektivisht procesit burokratik të marrjes së saj dëshmohet edhe me faktin se prodhuesi kryesor/më i madh i energjisë elektrike në Kosovë, Korporata Energetike e Kosovës [KEK], operon centralin elektrik Kosova A ngjashëm me licenca të përkohshme të cilat vazhdohet në baza vjetore, dhe e gjithë kjo për shkak të pamundësisë së KEK-ut që të pajiset me Leje Mjedisore të lëshuar nga MMPH. Kjo dëshmohet edhe me Vendimin e fundit për vazhdimin e licencës të lëshuar nga ana e ZRRE-së me numër V_1185_2019 e datës 14 tetor 2019.

Prova Nr. 15: Vendimi Nr. V_1185_2019

1.18. Motivi tjetër i të Paditurës që e Paditura pretendon që e kanë shtyrë të marrë iniciativën për të investiguar këtë rast është se hidrocentralet e Paditësit i kanë shkaktuar dëme të riparueshme ambientit. Këto deklarata nuk qëndrojnë pasi që mjedisi nuk është degraduar, por është rikultivuar dhe rehabilituar plotësisht, fakt i cili është konfirmuar poashtu edhe nga Njësia kundër krimit mjedisor e Policisë së Kosovës. Të gjitha licencat e poseduara nga Paditësi janë të bazuara në Studimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili jo vetëm që është prezentuar por edhe është diskutuar publikisht në vitin 2011, dhe Inspektorati i Ministrisë të Infrastrukturës dhe Ambientit mbikëqyrë rregullisht operimin e hidrocentraleve dhe mbikëqyr përputhshmërinë e tyre me udhëzimet mjedisore të parkut kombëtar.

1.19. Videoja e publikuar nga e Paditura me datë 13 maj 2020, së bashku me letrat e dërguara në ZRRE dhe MMPH, përmban shpifje dhe fotografi të vjetra/falso të përdorura në mënyrë manipuluese nga ana e të Paditurës. Në minutin 0:09 të kësaj video, përsëri kontestohet ligjshmëria e hidrocentralit të Paditësit dhe paraqitet një zonë ndërtuese e cila jo vetëm që nuk i përket ndërmarrjes Kelkos Energy – kjo fotografi mund të jetë e shkarkuar nga interneti apo mund ti përkasë ndonjë ndërmarrje tjetër në Kosovë. Në minutin 0:15 të kësaj videoje, shfaqet fotografia e ndërtimit të një tubacioni të metaltë i kombinuar me mbishkrimin: "Për disa vite, as Decanasët nuk ishin në dijeni se cka po ndodh në bjeshkët e tyre, deri sa uji filloi të ndabet në racione." Paditësi fare nuk operon në Hidrocentralet në Deçan me tubacion të metaltë, pra sërish fotografia e publikuar nuk i përket veprimtarisë të hidrocentralit të Paditësit.

1.20. Në video po ashtu elaborohen deklaratat e njejta të pavërteta sikurse në letrat e dërguara për kundërligjshmërinë e aktivitetit të Paditësit. Në përfundim të videos, paraqitet zona e 'Zalli Rupe', ku kompania Lika Sh.p.k e cila po e bënë ndërtimin e rrugës Deçan-Plavë, ka gërmuar zallin, kështu duke e fajësuar Paditësin për dëme në mjedis për çka nuk është përgjegjës.